

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a.

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX Sh.a.

**Raporti i audituesit të pavarur
dhe Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a.

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Më 31 dhjetor 2020

Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Aktivet		
Aktivet afatshkurtra		
Aktive afatgjata materiale	2,574,685	0
Totali i aktiveve afatgjata	5 2,574,685	0
Aktivet afatgjata		
Mjete monetare dhe ekuivalentët të tyre	6 86,473,883	0
Të tjera të arkëtueshme	7 162,469,736	0
Inventarë	8 0	0
Totali i aktiveve afatshkurtra	248,943,620	0
Totali i aktiveve	251,518,305	0
Detyrimet		
Detyrimet afatgjata		
Huamarrje afatgjata	0	0
Totali i detyrimeve afatgjata	0	0
Detyrime afatshkurtra		
Detyrime ndaj punonjësve	8,772	0
Detyrime tatimore	323,100	0
Detyrime të tjera	2,762,709	0
Totali i detyrimeve afatshkurtra	9 3,094,581	0
Totali i detyrimeve	3,094,581	0
Kapitali i vet		
Kapitali aksionar	250,000,000	0
Rezerva ligjore	0	0
Fitime të pashpëmdara	0	0
Fitim i vitit	(1,576,276)	0
Totali i kapitalit të vet	248,423,724	0
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	251,518,305	0

Pasqyrat Financiare në faqet 1 deri 4 janë firmosur dhe aprovuar më 09 shkurt 2021 nga:

Sokol DISHNYICA
Administrator i Përgjithshëm

Ilirë Simoni Ilirë
Përgjegjës i Financës

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet bashkë me grupin e shënimeve në faqet 5 deri 12 që përbëjnë një pjesë integrale të pasqyrave financiare.

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a.

Pasqyra e Fitimit apo Humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhurat			
Të ardhura nga veprimtaria kryesore		0	0
Të ardhura bruto nga shitja		0	0
Të ardhura të tjera	10	25,779	0
Te ardhura të tjera		25,779	0
Shpenzime personeli	11	(1,191,526)	0
Shpenzime amortizimi	12	(25,779)	0
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	13	(384,050)	0
Fitimi nga aktiviteti operativ		(1,601,355)	0
Shpenzime financiare	14	(700)	0
Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare		(700)	0
Fitimi Para Tatimit		(1,576,276)	0
Shpenzime për tatimin mbi fitimin		0	0
Fitimi (humbja) neto		(1,576,276)	0
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		0	0
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		(1,576,276)	0

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet e vendosura në faqet 5 deri 12 që përbëjnë një pjesë integrale të pasqyrave financiare.

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a.

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Kapitali	Rezerva ligjore	Rezerva tjera	Fitim i pasqyruar	Fitim i vitit	Totali
Më 1 janar 2019	0					0
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse gjate periudhes						
Fitimi (humbja) e periudhes						
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse						
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse						
Transaksione per pronaret te njohura ne kapital:						
Emetim kapitali						
Dividend i shperndare						
Totali i transaksioneve me pronaret						
Gjendja më 31 dhjetor 2019 sipas SNRF	0					0
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse gjate periudhes						
Fitimi (humbja) e periudhes					(1,576,276)	(1,576,276)
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse						
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse					(1,576,276)	(1,576,276)
Transaksione per pronaret te njohura ne kapital:						
Emetim kapitali	250,000,000		0	0	0	0
Dividend i shperndare						
Totali i transaksioneve me pronaret	250,000,000		0	0	0	0
Gjendja më 31 dhjetor 2020	250,000,000		0	0	(1,576,276)	248,423,724

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet bashkë me grupin e shënimeve në faqet 5 deri 12 që përbëjnë një pjesë integrale të pasqyrave financiare.

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a.

Pasqyra e Flukseve të Parasë

(metoda indirekte)

Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2019
Flukset e parasë nga veprimtaritë shfrytëzuese		
Fitim/humbja e vitit	(1,576,276)	
Amortizimi i aktiveve afatgjata	25,779	
Zhvlerësimi i te drejtave te arketueshme		
Renie/(rritje) ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera		
Renie/(rritje) ne inventare		
Renie/(rritje) ne detyrimet e pagueshme	494,117	
Flukset neto nga veprimtarite e shfrytëzimit	(1,056,380)	0
Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese		
Blerje aktivesh afatgjata	0	
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata	0	
Flukset e përdorura për veprimtaritë investuese	0	0
Flukset e parasë nga veprimtaritë financuese		
Derdhje e kapitalit te emtuar	87,530,264	
Pagesa e huave		
Dividend te shperndar		
Flukset e përdorura në veprimtaritë financuese		
Rritja neto e flukseve të parasë	87,530,264	0
Mjete monetare në fillim të periudhës	0	0
Mjete monetare në fund të periudhës	86,473,883	0

Pasqyra e lëvizjes së flukseve monetare duhet të lexohet bashkë me grupin e shënimeve në faqet 5 deri 12 që përbëjnë një pjesë integrale të pasqyrave financiare.

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(shumat në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a.

(më poshtë referuar si "Shoqëria") është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me datë 23 Tetor 2020 me NIPT M02223006B. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit 9901, datë 14 Prill 2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe nga Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme dhe statuti i saj. Objekti kryesor i aktivitetit të Shoqërisë është krijimi, menaxhimi dhe administrimi i tregut të organizuar të energjisë elektrike, nëpërmjet platformës së tregut në bazë të ditës në avancë dhe brenda të njëjtës ditë. Shoqëria zotërohet nga aksionarët Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sha dhe Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregu – KOSTT, të cilët zotërojnë respektivisht 57.25% dhe 42.75% të kapitalit themeltar.

Organet e drejtuese të Shoqërisë janë Asambleja e Përgjithshme e aksionarëve dhe Këshilli Mbikqyrës i përbërë nga 5 anëtarë.

Administratori i Shoqërisë është Z. Sokol Dishnica. Zyrat qendrore të Shoqërisë ndodhen në Autostradën Tr-Dr km.9, Yrshek, Kashar, Tiranë.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2020 është 5.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave

2.1 Pajtueshmëria

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK"), si dhe në përputhje me Ligjin Nr. 25/2018 datë 10.05.2018, "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara të shpallura me urdhërin e Ministrit të Financave nr. 64 datë 22.07.14 "Për shpalljen e detyrueshme të tyre". Shoqëria ka rezultuar me humbje për këtë vit kontabël për arsye se duke mos qenë akoma në proces operimi nuk ka gjeneruar të ardhura.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë.

2.2 Baza të matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të kompanisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(shumat në Lek)

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken. Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare.

3.Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente nga Shoqëria, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedha të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jomonetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kursi i këmbimit të përdorura në konvertimin dhe detyrimeve monetare në monedhë të huaj janë : 31 dhjetor 2020 1 Euro/123.7 Lek.

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiarë joderivative përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë joderivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë joderivative maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë se aktiviteti financiar ose kur Shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë depozita pa afat dhe depozita me një afat maturimi prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse.

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(shumat në Lek)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme (kërkesat e arkëtueshme) njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar, mospagesa ose pagesa të vonuara konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjonit llogaritet si diference midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.3 Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis afatit të aktivit dhe jetës së vlerësuar të dobishme të aktivit duke filluar nga dita kur ai është i gatshëm për përdorim. Aktivet e marra me qira financiare amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Pikturat sendet me vlere nuk amortizohen. Metodot e amortizimit dhe përqindjet përkatëse sipas grupeve të aktiveve afatgjata për periudhën aktuale janë si më poshtë:

Ndërtesa mbi vlerën kontabël neto 5%

Përmirësimet në qiramarrje mbi vlerën kontabël neto 10%

Makinëri dhe pajisje mbi vlerën kontabël neto 20%

Mjetë transporti mbi vlerën kontabël neto 20%

Orendi dhe pajisje zyre mbi vlerën kontabël neto 20%

Kompjutera dhe pajisje informatike mbi vlerën kontabël neto 25%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale që kanë një jetë të përcaktuar maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Amortizimi llogaritet mbi koston e blerjes së

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(shumat në Lek)

aktivit të zvogëluar me vlerën e tij të mbetur. Shuma e amortizimit kalon në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në menyrë zbritëse përgjatë jetës së aktivit.

3.5 Zhvlerësimi Aktivet financiare dhe jo financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të pasasë, të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar të disponueshëm për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivitetet jofinanciare

Vlera e mbetur e aktiveve jofinanciare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikupërueshme e aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikupërueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset hyrëse bruto të përfitimeve ekonomike lindur në rrjedhën normale të aktiviteteve të shoqërisë që rezultojnë në rritje të kapitalit neto gjatë periudhës dhe nuk përfshijnë rritjet e kapitalit neto në saj të kontributeve të ortakëve. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar apo të arkëtueshme nga shitja e mallrave në rrjedhën normale të aktiviteteve të shoqërisë. Të ardhurat nuk përfshijnë tatimin e vlerës së shtuar, kthimet, skontot dhe zbritjet, nëse ka. Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e raportimit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi për llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(shumat në Lek)

3.8 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet si fitim ose humbje përveç nëse lidhet me zëra të njohur direkt në kapital, rast në të cilin njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme. Tatimi i shtyrë lind nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet e shoqërisë të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me kërkesat e SNKK dhe vlerave të njohura të këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore.

4. Menaxhimi i riskut financiar

Aktiviteti i kompanisë është i ekspozuar kundrejt disa risqeve financiare si: risku i kursit të këmbimit, risku i kredisë dhe risku i përqindjes së interesit. Menaxhimi i riskut financiar drejtohet dhe fokusohet në paparashikueshmërinë e tregut financiar dhe synon të minimizojë efektet potenciale të papëlqyeshme. Menaxhimi i riskut financiar ndërmerret nga departamenti financiar i kompanisë.

(i) Risku nga kursi i këmbimit

Shoqëria është ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit që vjen si rezultat i ekspozimit në monedha të ndryshme kryesisht në lidhje me Euro-n. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument për tu mbrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Drejtimi i shoqërisë është përgjegjës për të mbajtur pozicione neto të përshtatshme në çdo monedhë dhe në total dhe të monitorojë operacionet e përditshme.

(ii) Risku i kreditit

Rreziku i kreditit është rreziku i humbjes financiare për shoqërinë nëse klientët ose palët e tjera nuk përmbushin detyrimet kontraktuale dhe lind kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të shoqërisë. Ekspozimi i shoqërisë ndaj rrezikut të kreditit është kryesisht i influencuar nga karakteristikat individuale të çdo klienti.

(iii) Risku i normës së interesit

Të ardhurat e shoqërisë dhe fluksi monetar operues janë thellësisht të pavarura nga ndryshimet në treg të normës së interesit.

(c) Risku i Likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që një njësi ekonomike do të përballet me vështiresi për të përmbushur detyrimet që lidhen me pasivet financiare. Drejtimi monitoron çdo ditë, javë dhe muaj duke bërë parashikime për flukset e parave.

5. Aktive afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020
	Vlera në Lek
Autoveturë tip Ford	2,296,140
Aktivitet afatgjata materiale	867,267

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(shumat në Lek)

	Mjete Transporti	Te tjera	Totali
Kosto			
Me 1 janar 2019	0	0	0
Shtesa			
Pakesime			
Më 31 dhjetor 2019	0	0	0
Shtesa	2,296,140	867,267	3,163,407
Pakesime			
Më 31 dhjetor 2020	2,296,140	867,267	3,163,407
Zhvlerësimi i akumuluar			
Me 1 janar 2019	0	0	0
Shtesa			
Pakesime			
Më 31 dhjetor 2019	0	0	0
Shtesa	353,252	235,470	588,722
Pakesime			
Më 31 dhjetor 2020	353,252	235,470	588,722
Vlera kontabël neto			
Me 1 janar 2019	0	0	0
Më 31 dhjetor 2019	0	0	0
Më 31 dhjetor 2020	1,942,888	631,797	2,574,685

6. Mjete monetare

Mjetet monetare përbëhen si më poshtë:

31 Dhjetor 2020

			Vlera në Lek
Arka	Lek	0	0
Raiffeisen Bank	Lek	86,350,493	86,350,493
Raiffeisen Bank	Euro	997.5	123,390
Totali			86,473,883

7. Kërkesa të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme

Sipas marrëveshjes së aksionerëve gjatë vitit 2020 është arkëtuar 35% e vlerës së kapitalit të nënshkruar dhe ka mbetur pa arkëtuar 65% e kapitalit e cila duhet të arkëtohet brenda vitit të parë të krijimit të shoqërisë.

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(shumat në Lek)

Kërkesat e arkëtueshme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 është kapitali i paderdhur i ortakëve.

	31 Dhjetor 2020
	Vlera në Lek
Te drejta ndaj ortakëve	162,469,736

8. Inventari

Inventari i Shoqërisë më 31 Dhjetor 2020 është 0.

9. Detyrimet për t'u paguar dhe parapagime

Detyrimet për t'u paguar dhe parapagimet më 31 Dhjetor 2020 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020
	Vlera në Lek
Sigurime shoq shënd	161,104
TAP	126,019
Tatim në burim	25,977
Të pagueshme ndaj punonjësve	8,772
Dieta per personelin	14,844
Penalitete e interesa për sig.shoq.shënd.	10,000
Personel jashte njesise	147,203
Detyrim kontrate hua perdorje	2,574,685

10. Të ardhurat për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 janë 25.779 Lek, që vjen nga përdorimi I disa aseteve të OST, pa pagesë sipas kontratës Huapërdorje.

11. Kosto e personelit

Kosto e personelit përbëhet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020
	Vlera në Lek
Shpenzime për paga	1,088,818
Shpenzime për sigurime shoq shënd	102,708

12. Shpenzime amortizimi për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 janë 25.779 Lek, që vjen nga asetet të cilat janë marrë nga OST sipas kontratës Huapërdorje.

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(shumat në Lek)

13. Shpenzime të tjera operative

	31 Dhjetor 2020
	Vlera në Lek
Shpenzime për personelin (akomodim, dieta,uniforma etj.)	14,844

14. Të ardhura (shpenzime) nga kurset e këmbimit, neto Të ardhurat (shpenzimet) nga kurset e këmbimit për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020 janë si me poshtë :

Humbje të realizuara nga kursi i këmbimit 700 Lek

15. Tatim-fitimi

Në përputhje me ligjet tatimore shqiptare, norma e aplikueshme për tatimin mbi fitimin për vitin 2020 është 15%. Deklaratat tatimore dorezohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2020 rezulton me humbje në vlerën 1.576.276 Lek.

16. Ngjarje pas datës së bilancit

Pas datës së bilancit nuk ka ndodhur ngjarje që mund të kërkojnë ndonjë rregullim ose prezantim në pasqyrat financiare.